



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË SHTIMES PËR VITIN 2021

Prishtinë, qershor 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Shtimes për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Shtimes (KSH), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Shtimes , prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Shtimes kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Komuna kishte të angazhuar katër (4) punonjës me kontrata me marrëveshje për shërbime të veçanta pa zhvilluar procedura të prokurimit.
- A2 Komuna kishte lidhë kontratë për “Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore për komunën e Shtimes - Kontratë kornizë për 36 muaj”, pa përcaktuar sasi të indikative, edhe pse për të gjithë artikujt/pozicionet e përfshira në këtë kontratë ishin të mundshme të mateshin me pragun apo tavanin plus/minus tridhjetë përqind (30%).
- A3 Gjatë ekzaminimit të tenderëve për tri aktivitete të prokurimit për punë autoriteti kontraktues nuk i kishte ngarkuar projektet ekzekutive në platformen e-prokurimi.
- A4 Te detyrimet e papaguara, kemi vërejtur se pesë (5) fatura në vlerë të përbashkët 111,107€ nuk ishin paguar brenda afatit ligjor (30 ditë), vonesat ishin nga 118 deri 236 ditë.
- A5 Komuna nuk kishte përgaditur Planin Vjetor për mbështetje financiare të Organizatave Jo Qeveritare.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës së Shtimes është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës së Shtimes është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës së Shtimes është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Shtimes .

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Shtimes është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Shtimes në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Shtimes me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Shtimes .
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur se sistemi i kontrollit të brendshëm në Komunën e Shtimes nuk kishte funksionuar si duhet në shumicën e fushave të menaxhimit financiar. Fusha për përmirësim mbasin si: prezantimi i informacionit financiar në raportin vjetor financiar duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese, procesi i realizimit të pagesave nga projektet tjera, dobësi në procedimin e pagesave, proceset në menaxhimin e tatimit në pronë, të arkëtueshmet, dobësi në regjistrimin e pasurisë jo financiare dhe menaxhimi jo i duhur i obligimeve. Këto çështje janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve dhe kërkojnë veprime konkrete që të përmirësojnë funksionimin e kontrolleve të brendshme të buxhetit të komunës.

Ky raport ka rezultuar me 15 rekomandime, prej tyre 12 janë rekomandime të reja dhe tri (3) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Angazhimi i stafit për marrëveshje për shërbime të veçanta

Gjetja Sipas nenit 84 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtar Publik, përcakton se Marrëveshjet për shërbime të veçanta, lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik ku, sipas paragrafit 4 të ndryshim plotësimit të rregullave për prokurim të shërbimeve të veçanta (konsulent/kontraktorët individual) këto rregulla aplikohen vetëm për prokurimin e shërbimeve të veçanta të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit. Marrëveshjet për shërbimet e veçanta lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik.

Komuna kishte të angazhuar katër (4) punonjës me kontrata me marrëveshje për shërbime të veçanta pa zhvilluar procedura të prokurimit për pozitën si Tutor në qendrën mësimore, kjo është kostatuar me dëshmi edhe nga ana e komunës.

Një dukuri e tillë sipas menaxherit të personelit ka ndodhur për shkak të nevojës së mëtejme për angazhimin e stafit për realizimin e objektivave shtesë të komunës.

Ndikimi Anashkalimi i procedurave të prokurimit në lidhje me mbulimin e pozitive me kontrata për shërbime të veçanta, përveç mos respektimit të procedurave ligjore, po ashtu, e rritë edhe rrezikun e angazhimit të personave jo adekuat për pozita të caktuara, çka mund të reflektoj edhe në performancën e tyre në punë.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e shërbime të veçanta, duke u kujdesur që personeli i angazhuar të jetë meritör, në mënyrë që të jenë në gjendje të përmbushin detyrat e kërkuara në mënyrë cilësore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Procedura e prokurimit jo në pajtim me RRUOPP

Gjetja Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik (RRUOPP) neni 56.10 përcakton, "Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Kurdo që Autoriteti kontraktues specifikon sasinë indikative, Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë devijimin prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%)."

Komuna kishte përcaktuar gabimisht procedurën për kontrata kornizë, sikur të ishte rasti për blerjet që nuk dihen sasi të indikative, që duhej të përcaktohen peshët në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimit" ose secilit "artikull", ku në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%). Bazuar në këtë procedurë, Komuna kishte lidhë kontratë për "Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore për komunën e

Shtimes - Kontratë kornizë për 36 muaj”, pa përcaktuar sasi të indikative, edhe pse për të gjithë artikujt/pozicionet e përfshira në këtë kontratë ishin të mundshme të mateshin me pragun apo tavanin plus/minus tridhjetë përqind (30%). Si pasojë e gjendjes së më sipërme, në këtë kontratë edhe çmimet për njësi ishin jo normalisht të ulëta, respektivisht nga gjithsej 30 artikuj/pozicione, 26 prej tyre kanë çmimin 0.01€. Vlera e parashikuar e kontratës ishte 95,000€ dhe kishte përcaktuar tavanet me plus/minus 30% të vlerës së parashikuar.

Ndërsa gjatë realizimit të kësaj kontrate, vërehen se për dy pagesa (situacione) janë paguar vetëm për 4 artikuj/pozicione me çmime nga 0.01€ dhe me sasi të vogla, ndërsa tek ato 4 pozicionet/artikujt tjerë me çmime me të larta ishin realizuar të gjitha dhe me sasi të shumta. Respektivisht gjatë vitit 2021 ishin paguar 30,000€ për dy situacionet, nga kjo shumë ishin paguar vetëm 13,40€ për pozicionet/artikujt me çmime 0.01€. Kjo kontratë është në proces të realizimit të saj nga 12.04.2021 deri me 10.04.2024.

Kjo kishte ndodhur për shkak të keq klasifikimit të procedurës së prokurimit dhe të kujdesit jo të mjaftueshëm në përpilimin e specifikave teknike, dhënies se kontratës dhe realizimit të saj.

Ndikimi Kjo mund të ndikojë në realizimin e vetëm disa pozicioneve/artikujve dhe jo të gjithave e në veçanti të atyre me çmime të ulëta, rrjedhimisht edhe mundësinë e dëmtimit të buxhetit.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë kontrollin e brendshme lidhur me procesin e hartimit të specifikave, të përcaktimit të procedurave dhe llojit të kontratave, vlerësimit të ofertave dhe të zbatimit të kontratave, në mënyrë që të arrijë qëllimet e planifikuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mos publikimi i projektit ekzekutiv në tenderët për punë

Gjetja Neni 28.10 i LPP kërkon: Specifikat Teknike për kontratat e punës duhet të përcaktojnë në mënyrë të saktë natyrën dhe karakteristikat e performancës të punëve të kërkuara. Specifikat Teknike duhet të përfshijnë, si pjesë substanciale të vetën, një projekt ekzekutiv. Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e Projektit Ekzekutiv, dhe i cili në mënyrë mandatore duhet të bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohej që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Gjatë ekzaminimit të tenderëve për “Asfaltimi i rrugëve dhe rregullimi i kanalizimit në fshatin Gjurkoc”, “Asfaltimi i rrugëve dhe rregullimi i kanalizimit të ujërave të zeza në Vojnoc”, dhe “Rregullimi i rrugës Devetak - Jezerc”, autoriteti kontraktues i kishte përgatitur projektet ekzekutive, por nuk i kishte bashkëngjitur në platformën e-prokurimi projektin ekzekutiv përkatës. Sipas zyrtarëve të komunës, projektin ekzekutiv të tenderit përkatës Operatorët Ekonomik (OE) që ishin të interesuar për ato tenderë e kishin marrë fizikisht në zyrat e komunës. Megjithatë, komuna nuk ishte në gjendje të ofrojë dëshmi që ndonjë prej OE ju kishte ofruar projektin ekzekutiv në fjalë.

Kjo sipas zyrtareve të komunës, kishte ndodhe për shkak të mos përkrahjes teknike e platformes e-prokurimi shkaku i hapësirës se pamjaftueshme për të ngarkuar në sistem të gjitha ato materiale elektronike voluminoze.

Ndikimi

Mungesa e projektit ekzekutiv në platformen e-prokurimit mund të ndikojë që punët e planifikuara të mos zhvillohen sipas kriterëve dhe standardeve të parapara, rrjedhimisht edhe në zbatim të planit dinamik të punëve.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të sigurojë se për çdo procedurë tenderuese për punë, përveç përgatitjes së projektit ekzekutiv të bëjë publikimin e tij së bashku me dokumentacionin tjetër për atë tender. Dhe kurdo që ndonjë OE merr fizikisht ndonjë dokument shtesë, të mbahet regjistër i dorëzimit pranimit të atyre dokumenteve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Vonesa në pagesën e detyrimeve

Gjetja

Ligji Nr.03/L-048 për MFPP, nenin 39.1, përcakton që "ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore".

Gjatë trajtimit të detyrimeve të papaguara kemi vërejtur se pesë (5) fatura nuk ishin paguar brenda afatit 30 ditor:

- Fatura e pranuar me 23.12.2020 në vlerë 78,114€, ishte paguar me 15.09.2021;
- Fatura e pranuar me 23.12.2020 në vlerë 12,000€, ishte paguar me 20.05.2021;
- Fatura e pranuar me 23.12.2020 në vlerë 14,342€, ishte paguar me 21.05.2021;
- Fatura e pranuar me 23.12.2020 në vlerë 3,951€, ishte paguar me 21.05.2021; dhe
- Vendimi i kryetarit për subvencionim i miratuar me 24.11.2020 në vlerë 2,700€, ishte paguar me 17.06.2021.

Pra vonesat e pagesave për këto raste janë nga 118 ditë deri në 236 ditë.

Mos pagesa e detyrimeve brenda afatit kohor ishte për shkak të planifikimit jo të mirë të alokimit dhe zotimit të mjeteve me kohë dhe iniciimi i procedurave të shpenzimeve pa mjete të mjaftueshme në dispozicion.

Ndikimi

Detyrimet e papaguara me kohë rrisin rrezikun në realizimin e projekteve dhe në arritjen e objektivave të komunës. Si rezultat i nevojës për t'i paguar obligimet e viteve paraprake, njëherit kjo mund të ndikon edhe në kosto shtesë në rast të padive nga furnitorët.

Rekomandimi A4

Kryetari duhet të sigurojë një planifikim më të mirë të alokimit dhe zotimit të mjeteve si dhe iniciimi i procedurave të shpenzimeve të realizohet vetëm kur mjetet janë në dispozicion me qëllim të eliminimit të vonesave për pagesat e faturave ndaj operatorëve ekonomik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Mos përgatitja e planit vjetor për mbështetje financiare për OJQ

Gjetja

Rregullorja MF - Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat Financimit Publik të Organizatave Jo Qeveritare (OJQ), Neni 6.1 përcakton se, Ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës dhe i dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

Komuna nuk kishte përgatitur Planin Vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve siç kërkohet me rregullorën përkatëse, me qëllim të vendosjes së një sistemi transparent dhe llogaridhënës për financimin me fonde publike të programeve dhe projekteve të OJQ-ve që janë të interesit publik në Republikën e Kosovës.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme.

Ndikimi

Mos përgatitja e planit vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve, paraqet mungesë të informatave se cilat fusha do përkrahen nga Komuna, si dhe qëllimet se për çfarë janë të parapara këto mjete.

Rekomandimi A5

Kryetari duhet të sigurojë që komuna të përgatitë planin vjetor për mbështetje financiare për OJQ-ve dhe të njëjtat t'i dërgohen me kohë zyrës për qeverisje të mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, dhe të sigurojë se i njëjti përmban të gjitha kërkesat e përcaktuara me rregulloren për mbështetje financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Kontrollat e brendshme në raportimin financiar

Në vijim janë çështjet që kanë të bëjnë me prezantimin e të dhënave dhe përgatitjen në Pasqyra Financiare.

Çështja A6 - Keq-klasifikimi i shpenzimeve

Gjetja Sipas nenit 18, pika 3 e rregullores Nr. 01/2013 - MF për Shpenzimin e Parasë Publike, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Pagesa në vlerë 2,730€ dhe pagesa 4,830€ për shpenzime të varrimit, janë paguar nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime derisa për nga natyra e shpenzimeve janë subvencione dhe transfere.

Sipas komunës, kjo ka ndodhur si shkak i mungesës së mjeteve financiare dhe mos planifikimit të mjeteve nga kategoria përkatëse.

Ndikimi Pagesat e bëra nga kategoria ekonomike jo-adekuate, ndikojnë në keq klasifikimin e shpenzimeve në PFV-të e Komunës dhe si të tilla japin informata jo të sakta për shfrytëzuesit e PFV-ve.

Rekomandimi A6 Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e sistemit të kontrolleve në këtë fushë, që planifikimi buxhetor i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve adekuate si dhe pagesat të regjistrohen në kode përkatëse në përputhje me planin kontabël të aprovuar nga Thesari.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A7 - Korrigjimi i Pasqyrave Financiare Vjetore

Gjetja Përgatitja e PFV-ve duhet të bazohet sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik dhe "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme si dhe sipas Rregullores së MFTP nr. 01/2017 për Raportimin vjetor financiar të organizatës buxhetore.

Pas rishikimit të PFV-ve, gjatë auditimit kemi konstatuar nevojën për korigjime në disa pozicione si:

Te neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit - pjesa dalja e parasë së gatshme, te shtylla buxheti fillestar, Shënimi nr. 6 investimet kapitale buxheti është prezantuar në shumë prej 1,807,000€, ndërsa sipas Sistemit Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK), shuma është 2,601,000€.

Te neni 14.6 - Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit - buxheti fillestar te pjesa dalje kategoria e investimeve kapitale, është prezantuar në shumë prej 1,807,000€, ndërsa sipas SIMFK-së shuma është 2,601,000€ (e shtuar nga shuma e Klauzolës së investimeve).

Të shënimet shpjeguese, shënim nr. 12. Të tjera nuk janë shpalosur saldo e depozitave në vlerë prej 3,560€, siç janë në SIMFK.

Pas identifikimit të gabimeve dhe këshillave nga auditimi, menaxhmenti i komunës kishte ndërmarrë veprime dhe kishte bërë korrigjimet e nevojshme dhe versioni i korrigjuar i PFV-ve ishte përgatitur dhe dorëzuar me kohë në Thesar.

Kjo kishte ndodhur për shkak të kontrolleve të brendshme jo adekuate dhe kujdesit të mangët të stafit përgjegjës në përgatitjen e PFV-ve.

Ndikimi

Mos prezantimi i saktë dhe i plotë i informatave financiare dhe jo financiare në PFV, nuk paraqet një pamje të vërtetë dhe të saktë të të dhënave dhe ulë shkallën e besueshmërisë tek përdoruesit e synuar.

Rekomandimi A7

Kryetari duhet të shtoj kontrollet gjatë hartimit të PFV-ve, në mënyrë që PFV-të për vitin 2022 të mos përmbajnë gabime kontabël dhe administrative. Deklarata e dhënë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar duhet të nënshkruhet vetëm pasi që janë siguruar se PFV-të prezantojnë të dhëna të plota dhe të sakta.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2021 ishin në vlerë 523,133€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Komuna kishte rritje të të hyrave prej 184,937€ krahasuar me vitin paraprak. Përveç kësaj vlere, të hyrat nga gjobat në trafik dhe të hyrat nga Agjencioni i Pyjeve ishin në vlerë të përgjithshme 114,810€, të cilat i alokohen Komunës për shpenzim.

Çështja A8 - Përfitimi i dyfishtë i zbritjes për vendbanimin parësor të tatimit në pronë

Gjetja Ligji nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, Neni 11, Zbritja për vendbanimin parësor, paragrafi 4. Personi fizik i cili ka në pronësi apo posedim dy (2) ose më shumë njësi rezidenciale të objekteve, mund të deklarojë vetëm një prej këtyre objekteve si vendbanimin e tij parësor, me ç'rast i lejohet zbritja 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit.

Gatë analizimit të të dhënave në regjistrin e tatimpaguesve të kategorisë së pronësisë “për banim” vërejtëm se në 15 raste janë të regjistruar dy prona të të njëjtit pronar si njësi të vendbanimit të tij parësor. Po ashtu, edhe të dy tatimpagues tjerë me tri njësi banimi, ishin të regjistruara si vendbanim të tij parësor. Në të gjitha këto raste, është aplikuar zbritja e lejuar prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit si bazë për kalkulimin e tatimit.

Kjo gjendje ishte kryesisht për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme dhe mos verifikimit të pronave në fjalë për t'i përditësuar të dhënat në sistemin e tatimit në pronë.

Ndikimi Regjistrimi i dy e me shumë njësi të banimit të të njëjtit pronarë si vendbanim parësor ndikon direkt në zvogëlimin e të hyrave nga tatimi në pronë.

Rekomandimi A8 Kryetari duhet të ndërmarr veprimet e nevojshme në forcimin e kontrolleve të brendshme në identifikimin e të gjithë tatimpaguesve të tatimit në pronë, që kanë përfituar dy herë zbritjen e lejuar për njësinë e banimit parësor, dhe t' i korrigjoi statutin e pronës se dytë dhe të tretë të të njëjtit pronar si vendbanim dytësor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 4,337,862€, të cilat janë shpenzuar në tërësi. Numri i lejuar i stafit me buxhet/planifikim ishte 665 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 643.

Çështja B1 - Pagesa e zyrtarëve të AME-së në mungesë të informatave për dosjen e tyre

Gjetja

Bazë për kompensimin e pagave dhe shtesave eventuale duhet të jetë kontrata e punës dhe dëshmitë e punonjësit që kanë punuar gjatë periudhës përkatëse.

Komuna kishte vazhduar të kompensoj tetë (8) zyrtarë/zjarrfikës, në mungesë të informatave (kontratave dhe dëshmime të punës). Kjo ka ndodhur si pasojë e asaj se këta zyrtarë, sipas legjislacionit në fuqi konsiderohen si punëtorë të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave (AME) në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB). Po ashtu, në bazë të marrëveshjeve të mirëkuptimit, të gjitha kompetencat rreth menaxhimit, përfshirë menaxhimin e dosjeve të punëtorëve janë bartur nga Komuna në AME, respektivisht MPB. Megjithatë buxheti i pagave për këtë staf, ka mbetur ende tek komuna. Prandaj, komuna vazhdon të kryej kompensimin e pagave dhe shtesave nga buxheti i saj. Pagat dhe shtesat për këta punëtorë gjatë vitit 2021 ishin 61,095€. Komuna nuk ka pranuar asnjë dëshmi apo konfirmimin nga AME që këta zyrtar kanë punuar gjatë vitit.

Kjo çështje po vazhdon të përsëritet vit pas viti. Sipas komunës, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve nuk ka ndërmarr hapa për bartjen e buxhetit në MPB, në mënyrë që kompensimet për këta punëtorë të bëhen nga vetë ministria.

Ndikimi

Pagesa e zyrtarëve në mungesë dëshmime për punë, mund të rezultojë me pamundësinë për të justifikuar pagesën e pagave dhe shtesat eventuale, apo mund të rezultojnë me pagesa të parregullta.

Rekomandimi B1

Kryetari, deri në bartjen përfundimtare të buxhetit tek MPB, duhet të kërkoj nga menaxhmenti i AME-së, që për zyrtarët të cilët paguhen nga buxheti i komunës, të sigurohen së paku kontratat e punës dhe konfirmimin që ata zyrtar kanë punuar gjatë muajit përkatës, për tu siguruar se janë paguar vetëm punëtorët që kanë përmbushë detyrimet nga marrëdhënia e punës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 2,735,281€, prej tyre ishin shpenzuar 61.2%. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e trotuareve, të kanalizimeve, ndërtim të rrugëve lokale, të ujësjellësve, objekteve arsimore, objekteve kulturore, mirëmbajtje investive, fushave sportive, pajisjeve mjekësore, pagesave me vendime gjyqësore, etj.

Çështja A9 - Vonesat në ekzekutimin e punëve për ndërtimin e shkollës në Carralevë

Gjetja

Kontrata e nënshkruar me datën 14.06.2017 për “Ndërtimin e shkollës fillore në Carralevë” me vlerë 529,029€, në kushtet e veçanta të saj përcakton se: Data e fillimit të punëve do të jetë me 19.06.2017, dhe data e përfundimit të të gjitha punëve do të jetë 02.09.2019. Mbulimi i financimit të kësaj kontrate do të bëhet nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) ndërsa procedurat e prokurimit nga Komuna.

Operatori ekonomik nuk kishte arrit që t'i përfundojë të gjitha punët sipas kontratës bazë dhe me datë 02.09.2019 kishte nënshkruar aneks kontratë për punët shtesë në vlerë 48,322€ dhe në afat shtesë të përfundimit të punëve deri me 01.09.2020.

Edhe pas kësaj kohe nuk ishin përfunduar të gjitha punët, për shkak të mos pagesave me kohë nga ana e MASHT-it dhe punëve shtesë të paparashikuara me kontratë. Me pëlqimin e të dy palëve nënshkruese kjo kontratë ishte shkëputur duke mbetur shkolla e pa ndërtuar.

Komuna me datën 09.07.2020 kishte ndërprerë kontratën sipas kushteve të përcaktuara se: “nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethanat emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, menaxheri i projektit me pëlqimin e kontraktorit do ta përfundoj vazhdimin e punimeve”.

Për ndërtimin e kësaj shkolle, nga buxheti i komunës ishin paguar 38,314€ (në vitin 2018 dhe 2020), ndërsa nga buxheti i MASHT-it janë paguar 472,898€ (për vitet 2017 deri 2019). Gjithsej për këtë kontratë janë paguar 511,212€.

Ndërsa sipas procesverbalit mbi pranimin teknik të datës 23.07.2020, pozicionet e punëve të kryera ishin 492,125€, kurse të pa kryera ishin 36,903€. Andaj në mes të punëve të kryera dhe pagesave të bëra kishte një diferencë për 19,087€ që ishin paguar më shumë.

Për të përfunduar punët e mbetura komuna kishte nënshkruar kontratë të re me tjetër OE me datën 10.12.2020 në vlerë 114,202€ për të përfunduar të gjitha punët deri me 10.07.2021.

Ekipi i auditimit ka bërë ekzaminim fizik të saj (me datë 10.05.2022) dhe konstaton se shkolla ende nuk ishte e përfunduar edhe pas përfundimit të afatit të kontratës së re, ku shkolla do të duhet të ishte në përdorim nga 01 shtator 2021.

Sipas Komunës vonesat ishin për shkak të pengesave të ndryshme në terren gjatë realizimit të projektit dhe nevojës për punë shtesë të paparashikuara në kontratën bazë. Megjithatë, vonesat ishin për shkak të planifikimit jo të mirë të projektit dhe menaxhimit të dobët të kontratës.

Ndikimi	Vonesat e gjata në realizimin e projekteve e zvogëlojnë vlerën e tyre dhe rrisin kostot shtesë me ndikim në buxhetin e komunës, ndërsa pagesa përtej punëve të kryera e dëmton buxhetin.
Rekomandimi A9	Kryetari duhet të sigurojë se para inicimit të procedurave të prokurimit ka analizuar dhe ka zgjidhur të gjitha pengesat e mundshme. Në anën tjetër, të sigurojë se punët kryhen sipas afateve të përcaktuara në kontratë dhe pa vonesa, në mënyrë që të shmangen shpenzimet eventuale shtesë si dhe ndikimet tjera buxhetore. Derisa për diferencën e paguar përtej punëve të kryera, ta trajtoj me OE në mënyrë që mjetet shtesë t'i kthej në buxhetin e komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.5 Pasuritë kapitale dhe jokatitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 52,407,791€, pasurive jokatitale është 508,498€, si dhe e stoqeve 17,003€.

Çështja A10 - Mangësi në vlerësimin/zhvlerësim të pasurive jo financiare

Gjetja

Neni 1 i Rregullores Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare përcakton procedurat standarde për dokumentimin, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jofinanciare, mbajtjen e saktë të të dhënave mbi pasurinë jo financiare përmes mirëmbajtjes sistematike të Regjistrit të Pasurive jo Financiare Kapitale, si pjesë integrale e SIMFK-së, dhe Regjistrit të Pasurive jo Financiare jo Kapitale me qëllim të vlerësimit dhe raportimit të vlerës së tyre, si dhe proceset adekuate, efikase, efektive dhe transparente të tjetërsimit të pasurive jofinanciare.

- Për pasurinë e regjistruar në SIMFK me emërtimin “Ndërtimi i qerdhës së fëmijëve” në vlerë 80,219€, ishte përdorë norma e zhvlerësimit për 10 vite derisa duhej të ishte për 40 vite. Andaj kjo pasuri si rezultat i këtij gabimi ishte nënvlerësuar për 60,164€.
- Pasuria e regjistruar në SIMFK në qershor të vitit 2018 me vlerë 18,000€ me emërtimin “Ndërtimi i fushave sportive në Godanc”, ishte regjistruar me statutin “Investim në vijim”. Si rezultat i këtij regjistrimi nuk i është kalkuluar zhvlerësimi për 3 vite e gjysmë, duke e mbivlerësuar vlerën neto të pasurisë së komunës për 3,150€.
- Pasuria e regjistruar në SIMFK në vitin 2018 me emërtimin “Pajisje speciale mjekësore” në vlerë 17,970€ nuk ishte përdorë zhvlerësimi, andaj kjo si rezultat i këtij gabimi ishte mbivlerësuar vlera e kësaj pasurie për 14,376€. Po ashtu kjo pajisje ishte jashtë përdorimit (në defekt).
- Pasuria e regjistruar në SIMFK në vitin 2016 me emërtimin “Ndërtimi i rrugëve lokale” në tri pagesa të testuara me vlerë të përbashkët 65,516€, nuk ishte përdorë zhvlerësimi, andaj si rezultat i këtij gabimi ishte mbivlerësuar vlera e këtyre rrugëve për 16,379€.
- Pasuria e regjistruar në SIMFK në vitin 2007 me emërtimin “Toyota-17107” në vlerë 4,703€ nuk ishte përdorë zhvlerësimi, edhe pse kjo veturë ishte shitë në vitin 2015 dhe ende figuron me vlerën e saj të regjistruar që në vitin 2007, andaj kjo kishte ndikuar në mbivlerësimin pasurive për 4,703€.

Për më tepër, Vlera e pasurive nën 1,000€ në PFV ishte prezantuar në shumë 508,499€, por në listën e këtyre pasurive vërehet se disa pasuri nuk kanë të regjistruar “Zhvlerësimin e tanishëm” dhe “Zhvlerësimin e akumuluar” respektivisht e kanë me zero. Kjo si pasojë e mos funksionimit të sistemit “e-pasuria”, i cili gjatë vitit 2021 dhe gjatë tetë (8) muajve të vitit 2020 nuk kishte aplikuar zhvlerësimin e tyre dhe kjo kishte ndikuar në shumën e zhvlerësimit të pasurisë në fund të vitit. Mos zhvlerësimi i pasurive nën 1,000€ gjatë kësaj periudhe ka ndikuar në mbivlerësimin e këtyre pasurive.

Kjo gjendje ishte kryesisht për shkak të mungesës së njohurive lidhur me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive si dhe mungesës së udhëzuesve të brendshëm lidhur me procesin e menaxhimit dhe korigjimeve të nevojshme në regjistrin e pasurive sipas nevojës së gjendjeve reale të vlerave dhe jetëgjatësisë së tyre.

Ndikimi Mos regjistrimi i duhur i pasurive sipas jetës së përdorimit, dhe mos korrjigjimi i regjistrit të pasurive sipas ndryshimeve të pronësisë dhe vlerës së pasurive, pamundëson marrjen e sigurisë lidhur me saktësinë dhe plotësinë e regjistrave të pasurisë.

Rekomandimi A10 Kryetari duhet të ndërmarr veprimet e nevojshme në forcimin e kontrolleve të brendshme për korrjigjimin dhe menaxhimin e regjistrit të pasurive, dhe në veçanti duke i verifikuar dhe korrigjuar vlerat e pasurive me statutin “Investime në vijim” dhe nëse jeta e përdorimit të pasurive është ajo e përcaktuara me rregullore dhe që vlera e pasurive të prezantohet e saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mangësi në procesin e inventarizimit të pasurive jo financiare

Gjetja Neni 19.4 i Rregullores Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare, përcakton se çdo fundvit duhet të behet inventarizimi, nga komisioni për inventarizim i cili është përgjegjës për: Inventarizimin e të gjithë pasurisë jo financiare që janë në pronësi dhe në kontroll të organizatës buxhetore, verifikimi fizik dhe cilësor të gjendjes së pasurisë jo financiare, krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare, dhe hartimi i raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të Komisionit për Inventarizimin e Pasurisë jo Financiare.

Komuna kishte themeluar komisionet (për 15 njësi) për të kryer procesin e inventarizimit të pasurive jo financiare (për secilën shkollë, ambulancë, qendra për punë sociale, shtëpia e komunitetit etj.). Tri prej këtyre komisioneve (qendra për punë sociale, shtëpia e komuniteteve, shkolla Emin Duraku) e kishin bërë një regjistrë jo të plotë për të gjithë pasurinë e tyre, kryesisht kishin inventarizuar ato pasuri të cilat nuk janë në përdorim, duke mos i inventarizuar edhe pasuritë në përdorim. Komisionet nuk kishin bërë krahasimin e gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare, dhe rrjedhimisht, nuk dihet diferenca mes gjendjes së kontabilitetit dhe inventarizimit. Po ashtu nëntë (9) prej këtyre komisioneve kishin përgatitur raportin e inventarizimit pas datës së përcaktuar në vendimin e themelimit të komisioneve.

Kjo gjendje ishte kryesisht për shkak të mungesës së njohurive lidhur me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive nga komisionet e inventarizimit, si dhe mungesës së udhëzuesve të brendshëm lidhur me procesin e inventarizimit të pasurive.

Ndikimi Mungesa e inventarizimit të pasurive në përdorim dhe mos krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurive, pamundëson marrjen e sigurisë lidhur me saktësinë dhe plotësinë e regjistrave të pasurisë.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë se procesi i inventarizimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, dhe të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat e konstatuara. Po ashtu raporti i përgjithshëm i inventarizimit të kryhet deri në datën e përcaktuar me vendimin për themelimin e komisioneve, dhe të gjitha ndryshimet në numrin ose vlerën e pasurive të cilat identifikohen

gjatë inventarizimit duhet të pasqyrohen në regjistrin e pasurive dhe në regjistrin kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.6 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV-të e vitit 2021 ka shpalosur Llogari të Arkëtueshme (LI.A) në vlerë prej 703,655€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë për objekte 525,323€, tatimi në pronë për parcela 176,345€ dhe nga qiraja në pronë dhe hapësira publike në vlerë prej 1,987€.

Çështja B3 - Llogaritë e arkëtueshme nga tatimi në pronë për Ndërmarrjet Shoqërore

Gjetja	Ligji Nr. 06/L-005 për tatimin në pronë, neni 12 paragrafi 2, përcakton se çdo komunë është përgjegjëse për administrimin e procesit të tatimit në pronë për pronat e paluajtshme që ndodhen brenda territorit të komunës. Komuna e Shtimes për vitin 2021 kishte raportuar llogari të arkëtueshme nga tatimi në prona prej 703,655€, ku një pjesë e borxheve të grumbulluara të tatimit në pronë prej 46,665€ i përkasin ish Ndërmarrjeve Shoqërore (NSh). Këto llogari të arkëtueshme janë bërë barrë aktuale vjetore e faturës së tatimit në pronë të cilat po rriten vit pas viti, dhe gjasat për inkasim të detyrueshëm mund të jenë të vogla. Sipas kontratës me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) blerësi i ri i pronës shoqërore ka obligim të paguaj tatimin në pronë vetëm për 12 muaj kalendarik, kurse pjesa tjetër e borxhit paguhet gjatë procesit të likuidimit. Gjatë vitit 2021 komuna e Shtimes kishte komunikuar me AKP-në dhe priten takime tjera mes palëve për zgjedhjen e problemeve të ngritura, mirëpo deri në kohën e auditimit zgjidhja nuk është arritur. Kjo kishte ndodhë për shkak të mungesës së njohurive të zyrtarëve për mos lejimin e shpenzimeve të parasë publike për këtë qëllim.
Ndikimi	Trendi i rritjes së vazhdueshme të këtyre llogarive të arkëtueshme ndikon në përkeqësimin e performancës së inkasimit të borxheve të komunës.
Rekomandimi B3	Kryetari të ndërmerr veprime adekuate për një zgjidhje të përbashkët me AKP-në lidhur me obligimet e NSh-ve të cilat janë nën menaxhimin e tyre dhe të ish NSh-ve të privatizuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A11 - Trendi rritës i Llogarive të Arkëtueshme

Gjetja	Sipas nenin 26 të ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme Nr. 06/L-005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10€) dhe neni 27 nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori. Komuna gjatë vitit 2021 nuk kishte një menaxhim efektiv në mbledhjen e llogarive të arkëtueshme, ku rritja e tyre nga viti paraprak ishte rreth 17%, pra nga 600,126€ në 703,655€.
---------------	---

Të arkëtueshmet nga tatimi në pronë për objekte ishte 525,323€ me një rritje rreth 5% nga viti paraprak, të arkëtueshmet nga tatimi në pronë për parcela ishte 176,345€ me një rritje rreth 76% krahasuar me vitin paraprak, ndërsa të arkëtueshmet nga qiraja e pronave dhe hapësirave publike ishte 1,987€ me një rritje rreth 91% nga viti paraprak.

Mangësitë e identifikuara në angazhimin e inkasimit të të arkëtueshmet të tatimit në pronë ishin se komuna nuk kishte ndërmarr ndonjë aktivitet për mbledhjen e tyre siç parashihet me ligjin për tatimin në pronë duke ju dërguar “Rikujtim për detyrimet e papaguara”. Në komunë janë 2,339 tatimpagues të tatimit në pronë borxhli që kanë mbi 10€ borxhe dhe deri në 1,376€, ndërsa komuna gjatë gjithë vitit 2021 kishte përcjell vetëm dy (2) rikujtime për detyrimet e papaguara tek tatimpaguesit borxhli dhe këto dy rikujtime ishin lëshuar me datën 15.12.2021.

Mungesa e funksionimit të kontrolleve të brendshme dhe angazhimit për inkasimin e të arkëtueshmeve ka sjell deri të mos pagesa e borxheve të tatimi në pronë.

Ndikimi

Mos arkëtimi i të arkëtueshmëve për vite me radhë, rrezikon që të vështirësohen mundësitë e arkëtimit apo të bëhen të pa mbledhëshme, dhe gjithashtu rezulton me të hyra vetjake më të ulëta për komunën.

Rekomandimi A11

Kryetari duhet të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se mbledhja e LI.A bëhet sipas kërkesave dhe mënyrave të përcaktuara ligjore duke i zvogëluar LI.A dhe rritjen e të hyrave të komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.7 Funksioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me Drejtorin dhe një auditor të brendshëm. NjAB kishte plan strategjik dhe planin vjetor të punës ku ishin planifikuar dhe realizuar gjashtë (6) auditime. Përderisa periudha e mbuluar me auditim ishte kryesisht viti 2021. Auditimet ishin fokusuar në fushën e prokurimit, pasurive, subvencioneve si dhe në fushën e të hyrave. Komiteti i auditimit ishte funksional gjatë vitit 2021 dhe kishte mbajtur katër (4) takime, ku kishte diskutuar raportet e auditimit të brendshëm, atë të zyrës kombëtare të auditimit, miratimin e planit vjetor të NjAB për vitin 2022.

Çështja A12 - Mos kompletimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm

Gjetja	Rregullore QRK - nr. 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik, neni 5 i saj përcakton, Kriteret për themelimin e Njesisë së auditimit të brendshëm dhe për zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm, subjekti i sektorit publik me buxhet mbi shtatë (7) milion € të ketë së paku tre (3) auditorë të brendshëm.
	Komuna që tri vite e kishte të përmbushur ketë kusht sipas buxheteve vjetore, që NjAB të plotësohej më një auditor shtesë, përderisa kjo njësi përbëhet nga Drejtori i saj dhe një auditor i brendshëm, ka një auditor me pak sesa që kerkohet.
	Plotësimin e NjAB-së edhe komuna e shef të rëndësishme, megjithatë, nuk janë vërejtur veprime konkrete në këtë drejtim, apo dhënies së rëndësisë së duhur nga menaxhmenti i komunës.
Ndikimi	Mos kompletimi i NjAB me staf të mjaftueshëm, mund të ndikojë që auditimi i brendshëm mos të mbulojë të gjitha fushat me rrezik, dhe t'i pamundësoj menaxhmentit marrjen e veprimeve me kohë për parandalimin e gabimeve të mundshme.
Rekomandimi A12	Kryetari duhet të sigurojë buxhetimin dhe plotësimin me staf të mjaftueshëm të NjAB-së për të ndikuar në forcimin dhe funksionimin e kontrolleve të brendshme në komunë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁴	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	8,309,317	8,526,479	7,172,793	7,820,655	8,476,969
Grante Qeveritare - Buxheti	6,925,223	6,886,555	6,530,067	7,093,061	6,424,316
Financimi përmes huamarrjes	0	15,098	15,098	45,045	9,026
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	793,562	793,562	56,810	255,124	1,471,012
Të bartura nga viti i kaluar	0	233,767	161,366	120,349	135,564
Të hyrat vetanake	590,532	590,532	402,960	306,158	315,984
Donacionet vendore	0	6,840	6,493	918	17,284
Donacionet e jashtme	0	125	0	0	103,784

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 217,162€. Rritja ishte nga: të hyrat vetanake të bartura në vlerë 233,767€, financim nga huamarrja në vlerë 15,098€ nga donacionet në vlerë 6,965€ dhe shkurtime të buxhetit final në krahasim me buxhetin fillestar nga granti qeveritar në vlerë 38,668€.

Në vitin 2021 komuna ka shpenzuar 84% të buxhetit përfundimtar, me një realizim më të ulët rreth 9% në krahasim me vitin 2020. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	8,309,317	8,526,479	7,172,793	7,820,655	8,476,969
Pagat dhe mëditjet	4,360,904	4,337,862	4,337,631	4,274,089	4,137,294
Mallrat dhe shërbimet	911,551	1,052,484	847,662	963,803	732,771
Komunalitë	220,000	220,000	156,468	197,717	191,821
Subvencionet dhe transferet	150,000	180,852	155,917	267,401	126,246
Investimet Kapitale	2,601,052	2,735,281	1,675,116	2,117,646	3,288,837
Rezervat	65,810	0	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Kategoria e pagave dhe mëditjeve në buxhetin final ishte 4,337,862€, kishte zvogëlim për 23,042€ apo 1% krahasuar me buxhetin fillestar dhe një realizim prej 99.99%.
- Kategoria mallra dhe shërbime në buxhetin final ishte 1,052,484€, kishte rritje buxhetit në krahasim me buxhetin fillestar për 140,933€, rritja ishte nga bartja e të hyrave vetjake nga vitet paraprake në vlerë 133,989€, dhe nga donacionet në vlerë 6,944€. Deri në fund të vitit, buxheti ishte realizuar rreth 81%.
- Kategoria e komunalive nuk kishte ndonjë ndryshim të buxhetit, ndërsa buxheti i realizuar ishte 155,917€ apo rreth 86%.
- Kategoria subvencioneve dhe transfereve në buxhetin final ishte 180,852€, kishte rritje të buxhetit në krahasim me buxhetin fillestar për 30,852€ dhe ishte realizuar rreth 86%. Rritja e buxhetit në vlerë 20,000€ ishte me rishikim të buxhetit dhe 10,852€ ishte destinuar për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e shiut dhe vërshimet.
- Kategoria investime kapitale në buxhetin final ishte 2,735,281€, kishte rritje të buxhetit në krahasim me buxhetin fillestar për 134,229€. Nga kjo vlerë, 65,810€ fillimisht ishin buxhetuar si rezerva dhe pastaj ishin rregulluar duke i buxhetuar për projekte kapitale, nga alokimi i të hyrave vetjake të bartura në vlerë 88,398€, nga donacionet në vlerë 21€. Ndërsa shkurtime nga granti qeveritar kishte në vlerë 20,000€ me vendimin e qeveris për harmonizimet në muajin dhjetor. Në fund të vitit buxheti ishte realizuar 61.24%.

Realizimi i ulët i buxhetit është si pasojë e venesave në realizimin e projekteve, ku kryesisht projekti “Ndërtimi i sitemit të kanalizimit për ujrat e zeza” financim nga huamarrja, për vitin 2021 ishte buxhetuar 793,562€, ndërsa realizimi ishte në vlerë 56,810€ apo 7.10%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara në vitin 2021 ishin në vlerë 523,133€ apo rreth 89% nga planifikimi. Ato kanë të bëjnë me: të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga taksa për lejet e ndërtimit, taksat për certifikata të ndryshme, të hyrat nga regjistrimi automjeteve, të hyrat nga ndërrimi i destinimit të tokës, taksa për regjistrim të trashëgimisë, të hyrat nga shfrytëzimi i pronës komunale, të hyrat tjera administrative, etj.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	590,532	590,532	523,133	338,196	429,285
Të hyrat tatimore	227,910	227,910	242,640	147,609	173,659
Të hyrat jo tatimore	362,622	362,622	280,493	190,587	255,627

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2020 të Shtimes ka rezultuar në nëntë (9) rekomandime kryesore. Komuna kishte diskutuar këtë raport në asamblenë komunale dhe kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, gjashtë (6) rekomandime janë zbatuar dhe tre (3) nuk janë adresuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të siguroj se vlera e pasurisë jo financiare duhet të jetë pjesë e PFV në pajtim me rregullën financiare për pasqyrat vjetore financiare. Pra, rezultatet e gjendjes së inventarizimit dhe vlerësimit duhet të reflektojnë ndryshimet e fundvitit në regjistrat kontabël të pasurive. Ndërsa, të gjitha blerjet e reja të pasurisë gjatë vitit, varësisht nga vlera e tyre, duhet të procesohen në sistemet përkatëse të regjistrimit të pasurisë.	Nuk kemi evidentuar raste të tilla gjatë vitit 2021.	I zbatuar

2.	Të hyrat	Kryetari duhet të fuqizoj kontrollet administrative në Drejtorinë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, në mënyrë që llogaritja e tarifave për shërbimet ndaj qytetarëve të jetë në harmoni me rregulloren komunale për taksa, tarifa dhe gjoba të Komunës, si dhe me udhëzimin përkatës. Ndërsa personit që ka marrë lejen ndërtimore, t'i kërkohet ta paguaj diferencën që ka rezultuar si gabim në llogaritje.	Nuk kemi evidentuar raste të tilla gjatë vitit 2021.	I zbatuar
3.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurohet se drejtoritë që realizojnë të hyra bëjnë barazimin me zyrtarin e të hyrave në baza të rregullta mujore bazuar në dokumente burimore dhe raporte e bankës duke eliminuar me kohë edhe dobësitë apo gabimet e mundshme.	Nuk kemi evidentuar raste të tilla gjatë vitit 2021.	I zbatuar
4.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari, deri në bartjen përfundimtare të buxhetit tek MPB, duhet të kërkoj nga menaxhmenti i AME-së, që për zyrtarët të cilët paguhen nga buxheti i komunës të sigurohen së paku kontratat për punë, për tu siguruar se janë paguar vetëm punëtorët që kanë përbushë detyrimet nga marrëdhënia e punës.	Edhe këtë vit gjendja është e njëjtë me vitin paraprak.	Nuk ka filluar zbatim
5.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të siguroj se zyrtarët përgjegjës të komisioneve për pranimin e mallrave/furnizimeve nuk duhet të pranojnë asnjë artikull që nuk është në përputhje me specifikat e kontratës. Ndërsa, pranimi i furnizimeve të bëhet nga Zyrtari i pranimit/logjistikës, si dhe pasuritë jo kapitale dhe stoqet të regjistruhen në sistemin e-pasuria.	Nuk kemi evidentuar raste të tilla gjatë vitit 2021.	I zbatuar
6.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e ndarjes së fondeve për subvencione, do të zbatohen të gjitha kërkesat që dalin nga rregullorja e brendshme për ndarjen e subvencioneve si dhe ligjet tjera në fuqi.	Nuk kemi evidentuar raste të tilla gjatë vitit 2021.	I zbatuar
7.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se ndarja e fondeve buxhetore do të realizohet, vetëm në përputhje me kontratat e lidhura për ato projekte kapitale, të planifikuara në tabelën buxhetore si dhe të përfshira në planin e prokurimit. Derisa, për projektet e paplanifikuara, para nënshkrimit të kontratës të siguroj fondet buxhetore përmes procedurave buxhetore në Ministrinë e Financave.	Nuk kemi evidentuar raste të tilla gjatë vitit 2021.	I zbatuar
8.	Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj se janë regjistruar vlerat e pasurive jo financiare në regjistrat kontabël sipas rregullores përkatëse për menaxhimin e pasurisë jo financiare dhe të jetë pjesë e raportit të PFV në pajtim me rregullat financiare.	Edhe këtë vit gjendja është e njëjtë me vitin paraprak.	Nuk ka filluar zbatim

9.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari të ndërmerr veprime adekuate për një zgjidhje të përbashkët me AKP-në lidhur me obligimet për NSh-të të cilat janë nën menaxhimin e tyre, dhe të ish NSh-ve të privatizuara. Po ashtu, duhet të ndërmerren të gjitha masat ligjore për arkëtimin e borxheve tjera nga të gjithë shfrytëzuesit e pronave.	Edhe këtë vit gjendja është e njëjtë me vitin paraprak.	Nuk ka filluar zbatimi
----	-------------------------	---	---	------------------------

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Enver Boqolli, Udhëheqës i ekipit



Aurora Morina, Anëtare e ekipit



Agim Sogojeva, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

Nr. Prot. 02/2 18



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE: 06.06.2022			
Klasifikim: 04 47919 1			
Org. Jedin.	Shif. Jedin.	Nr. Prot.	Nr. fletëve
Org. Unit	Class. Code	Prot. No.	No. Pages

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,


Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Shtimes, për vitin 2021
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Qemajl Aliu

Kryetar i Komunës së Shtimes

07 qershor.2022, Shtime



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁵ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁶, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.